



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-7215/20 datë:05.05.2020



Npi – 01/87 datë: 14.05.2020

Duke u bazuar në nenin 40 pikat b dhe c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Ligjin, Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të ndryshuar dhe plotsuar me Ligjin Nr.03/L-221; Si dhe në bazë të neneve 6 pika 2, dhe nenit 15 të Ligjit Nr.05/L-133, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Kuvendi i Komunës së Shtimes, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR RRRITJEN E KULMIT BUXHETOR PËR VITIN 2019

I

Kuvendi Komunës së Shtimes në mbledhjen e -III- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më 14.05.2020, unanimisht aprovoi Vendimin për rritjen e kulmit të Buxhetit për vitin 2019 të Komunës së Shtimes, për pjesën e financuar nga të hyrat vetanake e ndodhur nga ndikimi i realizimit/inkasimit për shumën prej 21,248.40€ në vitin 2019, mbi planifikimin e parapar prej 503.882€. Totali i financimit të Buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2019, do të jetë 525,130.40€.

II

A r s y e t i m: Rritja e aprovuar sipas dispozitivit të këtij vendimi në shumën prej 21,248.40€ është planifikuar të destinohet ne Investime Kapitale – Projektet e infrastruktures me participim, në programin, Planifikimi Urban dhe Mjedis - 617660-66340 Planifikimi Urban dhe Inspektion, Projekti-Kodi: 45315.

Komuna e Shtimes është përfituese e Grantit të performancës nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal se Bashku me DEMOS-in, që bashkëfinancohet nga Qeveria Zvicerane, Qeveria Suedeze dhe Qeveria Norvegjeze. Këto mjete do të dedikohen pjesës të participimit në këtë projekt nga Komuna.

III

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kryetarit të Komunës, Drejtorisë, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj